



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 81, datë 30.03.2023

MBI

MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË GODINËS, QË I PËRKET KOPSHTIT BIZË, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA DURRËS, QË MBAN NR. 12, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, QË ME VKM NR. 295, DATË 02.5.2012, I NDRYSHUAR ME VKM NR. 63, DATË 8.02.2023, KA KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM, PËR SHKAK SE ËSHTË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE ËSHTË REKOMANDUAR TË PRISHET E TË NDËRTOHET NGA E PARA, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS “MBI INSPEKTIMIN NË TERREN OBJEKT NDËRTIMI”, KRYER NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, DHE MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PËRFUNDIMTARE TË PRONËS ME EMËRTIMIN “KOPSHTIT BIZË”, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA DURRËS, QË MBAN NR.12 TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, QË ME VKM NR. 295/2012, I NDRYSHUAR ME VKM-NË NR. 63, DATË 8.02.2023, KA KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS



Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 295, datë 02.5.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Ishëm, të Qarkut të Durrësit”, i ndryshuar me VKM-së nr. 63, datë 8.02.2023, “Për një ndryshim në vendimin nr. 295, datë 02.5.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit,

në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “ Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr. 5059/1 prot., datë 21.5.2020, ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike të Bashkisë, me lëndë: “Përcjellje të ekspertizave të thelluara të hartuara, për godinat arsimore të dërguara nga Instituti i Ndërtimit me shkresë nr.998/1 prot, datë 15.5.2020, ligjit nr. 10296/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtoria e Arsimit-Kulturës, Rinisë, Sport, Komuniteteve Fetare dhe Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin për prishjen e detyruar të godinës, që i përket Kopshtit Bizë, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, që mban nr. 12, të listës së transferimit, që me VKM nr. 295, datë 02.5.2012, i ndryshuar me VKM nr. 63, datë 8.02.2023, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Ishëm, për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 Nëntor 2019 dhe është rekomanduar të priset e të ndërtohet nga e para, kjo sipas aktekspertizës “Mbi inspektimin në terren objekt ndërtimi”, kryer nga Instituti i Ndërtimit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
2. Miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista përfundimtare të pronës me emërtimin “Kopshti Bizë”, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, që mban nr.12 të listës së transferimit, që me VKM nr. 295/2012, i ndryshuar me VKM nr. 63, datë 8.02.2023, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës
3. Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në zbatim të Ligjit nr. 10296/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e ASHK-së, Durrës, të pronës me emërtimin “Kopshti Bizë”, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, që mban nr.12 të listës së transferimit, që me VKM nr. 295/2012, i ndryshuar me VKM-në nr. 63, datë 8.02.2023, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës.
4. Toka (trualli), i liruar nga prishja e godinës, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studjohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoret për rindërtimin e godinës, e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shembjen e godinës, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të mbulohet nga Inspektoriati Mbrojtjes Territorit Vendor, Bashkia Durrës.

6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Vendore, që bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkërendojnë punën me Njësinë zbatuese, që administron fondet për rindërtim, që transferohen nga Këshilli i Ministrave, prej fondit të rindërtimit, për të realizuar rindërtimin e objektit me emërtimin “Kopshti Bizë”, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të ndërtesës, pas realizimit të rindërtimit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Vendore, Drejtoria e Arsim-Kulturës, Rinisë, Sport, Komuniteteve Fetare dhe Drejtoria Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 31.03.2023





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 220 / prot.
2

Durrës, më 31.03 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.81 datë 30.03.2023 “Mbi miratimin për prishjen e detyruar të godinës, që i përket kopshtit Bizë, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, që mban nr. 12, të listës së transferimit, që me VKM nr. 295, datë 02.5.2012, i ndryshuar me VKM nr. 63, datë 8.02.2023, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Ishëm, për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe është rekomanduar të priset e të ndërtohet nga e para, kjo sipas aktekspertizës “Mbi inspektimin në terren objekt ndërtimi”, kryer nga instituti i ndërtimit, Ministria e Infrastrukturës dhe energjisë, dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista përfundimtare të pronës me emërtimin “Kopshtit Bizë”, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, që mban nr.12 të listës së transferimit, që me VKM nr. 295/2012, i ndryshuar me VKM-në nr. 63, datë 8.02.2023, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**

